



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 314/4 prot.

Tiranë, më 03.12.2018

VENDIM

Nr.99, datë 03.12.2018

PËR

**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 131, DATË 13.06.2017, NË
INSTITUCIONIN KËSHILLI I QARKUT TIRANË**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 131, datë 13.06.2017, “Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të procedurës së plotësimit të pozicioneve të punës që janë pjesë e shërbimit civil, filluar me Urdhërin nr.49 datë 18.05.2017”, në Këshillin e Qarkut Tiranë,

KONSTATOVA SE:

Me urdhrin nr. 49, datë 18.05.2017, “Për verifikimin e ligjshmërisë së procesit të rekrutimit në shërbimin civil, në Këshillin e Qarkut Tiranë”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka vendosur fillimin e verifikimit në lidhje me planin e rekrutimeve për vitet 2015, 2016, 2017 dhe aktet që materializojnë procesin e testimit të zhvilluara pas datës 1 maj 2015, në Këshillin e Qarkut, Tiranë.

Ky proces është përmbyllur me Vendimin nr.131, datë 13.06.2017, “Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të procedurës së plotësimit të pozicioneve të punës që janë pjesë e shërbimit civil, filluar me Urdhërin nr.49 datë 18.05.2017”, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në të cilin është vendosur:

1- Të kërkoj nga Kryetari i Këshillit të Qarkut Tiranë, që për rregullimin e ligjshmërisë, të anulojë:

✓ Aktin administrativ nr. 1709, datë 01.08.2016, për emërimin e punonjësese
***** në pozicionin e punës, “Sekretar i Përgjithshëm”

✓ Aktin administrativ nr. 1321, datë 16.06.2016, për emërimin e punonjësese
***** në pozicionin e punës, “Specialist Protokolli, Arkivës dhe Shërbimit ndaj Qytetarëve në Sektorin e Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore”.

2- Pozicionet e punës, “Sekretar i Përgjithshëm” dhe “Specialist i Protokollit, Arkivës dhe Shërbimit ndaj Qytetarëve në Sektorin e Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore”, pranë Këshillit të Qarkut Tiranë, duhet të plotësohen me anën e procedurave të konkurrimit të hapur, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore dalë për zbatim të tij, apo dhe nëpërmjet procedurave të lëvizjes paralele, në varësi të nivelit të pozicionit të punës.

Bazuar në nenin 14, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe në Rregulloren “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, më datë 06.03.2018, grupi i punës i ngarkuar nga Komisioneri, sipas programit të verifikimit nr. 314/1 prot. dt. 06.03.2018, u paraqit në institucionin e Këshillit të Qarkut Tiranë në datën 12.03.2018.

Gjatë vizitës në institucion, grupi i punës komunikoi me njësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe verifikoi materialet shkresore të cilat vërtetonin zbatimin e detyrave të lëna nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në Vendimin paralajmërues. Dokumentacioni shoqërues që administrohej nga kjo zyrë dhe zyra e Arkiv-Protokollit është pasqyruar në procesverbalin e datës 12.03.2018, të mbajtur nga grupi i punës i Komisionerit dhe personi i kontaktit të institucionit të Këshillit të Qarkut Tiranë, në pozicionin Drejtor i Drejtorisë Juridike, Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore.

Pasi u administruan dhe u trajtuan materialet shkresore të vëna në dispozicion, konstatoj se:

***** është larguar nga detyra e Sekretarit të Përgjithshëm nëpërmjet Urdhrit nr. 1514 prot, datë 05.09.2017, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Tiranë, si pasojë e dhënies së dorëheqjes nga kjo detyrë.

Referuar vendimit të Komisionerit, objekt i këtij verifikimi, akti i emërimit të përkohshëm të kësaj punonjëseje në pozicionin e “Sekretarit të Përgjithshëm” është një

akt absolutisht i pavlefshëm, i cili vjen në kundërshtim me kërkesat dhe procedurat e rekrutimit, të përcaktuara në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Për më tepër, akti në fjalë është nxjerrë nga titullari i institucionit, në kapërcim të kompetencave të tij ligjore, pasi administrimi i shërbimit civil bëhet nga njësi e menaxhimit të burimeve njerëzore.

Në kushtet e një pavlefshmërie absolute të veprimit administrativ, pasojat juridike janë nul, çka do të thotë se marrëdhënia e punësimit të ***** me institucionin e Këshillit të Qarkut konsiderohet si inekzistente. Për këtë arsye, në mungesë të një marrëdhënieje punësimi, ***** nuk mund të dorëhiqej nga detyra dhe as të përfundohej një “marrëdhënie” e tillë për shkak të dorëheqjes.

Megjithatë, duke qenë se tashmë gjendja e paligjshmërisë është ndërprerë, çmoj se njësi përgjegjëse e institucionit në fjalë, duhet të bëjë kujdes që në të ardhmen të zbatohet me përpikmëri ligjin, duke mbajtur parasysh edhe vërejtjet e Komisionerit.

Në momentin e verifikimit në subjekt, ***** , e cila ishte emëruar përkohësisht në kundërshtim me ligjin në pozicionin e punës, “*Specialist Protokoll, Arkivës dhe Shërbimit ndaj Qytetarëve në Sektorin e Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore*”, vazhdonte të ushtronte detyrën në këtë pozicion. Megjithatë, me shkresën nr.388 prot, datë 07.03.2018, “*Dërgohet njoftim për botim*”, drejtuar Shërbimit Kombëtar të Punësimit, njësi përgjegjëse e Këshillit të Qarkut Tiranë ka shpallur vakant pozicionin e punës “*Specialist Protokoll, Arkivës dhe Shërbimit ndaj Qytetarëve në Sektorin e Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore*” në Drejtorinë Juridike.

Sipas Drejtores së Drejtorisë Juridike, Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore, punonjësja në fjalë vazhdonte të ushtronte detyrën, në kushtet kur institucioni, sipas nenit 16 të ligjit 109/2017, “*Për buxhetin e shtetit për vitin 2018*”, ka të përcaktuar se personeli administrativ i Këshillit të Qarkut nuk mund të përbëhet nga më shumë se 10 punonjës dhe mungesa e specialistit të protokoll-arkivës do të shkaktonte probleme në mbarëvajtjen e punëve të institucionit.

Nëpërmjet komunikimit të vazhdueshëm me Këshillin e Qarkut Tiranë, Komisioneri është informuar se procedura e konkurrimit për pozicionin e punës “*Specialist Protokoll, Arkivës dhe Shërbimit ndaj Qytetarëve në Sektorin e Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore*” ka përfunduar. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të plotë që materializon zhvillimin e kësaj procedure vlerësoj se kjo procedurë është zhvilluar në përputhje me ligjin. Në përfundim, njësi përgjegjëse, me vendimin nr. 1, datë 18.05.2018, ka emëruar si nëpunës civil në periudhë prove ***** , e cila ka rezultuar fituese në përfundim të procedurës së konkurrimit.

Për sa u parashtrua më sipër, pas përfundimit të afatit për zbatimin e detyrave të lëna në Vendimin nr.131, datë 13.06.2017, “*Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të procedurës së plotësimi të pozicioneve të punës që janë pjesë e shërbimit civil, filluar*

me Urdhrin nr.49 datë 18.05.2017”, të Komisionerit, arrij në konkluzionin se nga ana e institucionit Këshilli i Qarkut Tiranë janë zbatuar plotësisht rekomandimet e lëna në vendimin paralajmërues.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 131, datë 13.06.2017, “Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të procedurës së plotësimit të pozicioneve të punës që janë pjesë e shërbimit civil, filluar me Urdhërin nr.49 datë 18.05.2017”, në Këshillin e Qarkut Tiranë.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësisë përgjegjëse të institucionit të Këshillit të Qarkut Tiranë, duke zbatuar rekomandimet e Vendimit Nr. 131, datë 13.06.2017.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni i Këshillit të Qarkut Tiranë dhe të informohet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA